



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legj. -III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI, ZHVILLIM
RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR**

Procesverbal Nr. 13
nga mbledhja e mbajtur më **6.6.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 13,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Heset Cakolli , Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zef Morina dhe Zylfi Merxha.

Munguan :

Ali Lajçi, Selvie Halimi, Ibrahim Selmanaj dhe Myrvete Pantina (udhëtim zyrtar).

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku, Lule Ymeri.

Pjesëmarrësit tjerë : Shefki Zeqiri, Blerim Vela dhe vëzhguesit e rregullt.

RENDI I DITËS :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Projektligjit të produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, dhe
3. Të ndryshme

Procesverbali nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi Berat Luzha hapi mbledhjen për shkak të mungesës së shkurtër të kryetarit dhe konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, ndërsa sa i përket procesverbalit nga mbledhja ku është shqyrtuar projektligji për bimët, **Elheme Hetemi** tha se ka bërë fjalë për masa ndëshkuese edhe për fermerët, e jo ashtu si është shënuar për masa preventive.

Projektligji për produktet për mbrojtjen e bimëve

Berat Luzha në fillim kërkoi sqarim nga grupi punues për projektligjet nga MBPZHR , ngase komisioni është njoftuar vetëm gojarisht për vërejtjet për këtë projektligj. **Elheme Hetemi** tha se këtë fakt tani e ka të njohur, ngase askush nuk ka kërkuar raport me shkrim lidhur me këtë projektligj, megjithatë ajo premtoi se këtë do të përgatit për mbledhjen e radhës. Edhe disa anëtarë tjerë (Zef Morina, Kosara Nikoliq) u pajtuan që kjo të praktikohet në të ardhmen , ngase është një lehtësim për punën e komisionit. **Shefki Zeqiri** tha se është njohur me vërejtjet e grupit punues (zj. Hetemi) me të cilat pajtohet me shumicën e tyre, por sa i përket “ndëshkimit të fermerëve” për shkak të mbetjeve nga pesticidet të cilën e kërkon zj Hetemi, ai me bashkëpunëtorët prezent sqaroi se nuk është tani koha për përcaktim të tillë të ligjit, dhe se ato i takojnë procedurave tjera. **Elheme Hetemi** megjithatë insistoi në këtë kërkesë ngase sistemi i inspektionit apo e kontrollit duhet të jetë një domosdoshmëri, dmth një fermer duhet të ketë qartë se çka është e lejuar e çka jo, ngase me praktikën e reja profilizimi i fermerëve është kriter, për çka në këtë drejtim do të ndihmonte ky ligj dhe nuk do të kishim fermer të palicencuar.

Berat Luzha ia dorëzoi kryesimin kryetarit duke sqaruar për çështjet e shtjelluara deri në atë moment. **Lulzim Zeneli** edhe një herë rikujtoi anëtarëve të komisionit se grupet punuese janë caktuar nga komisioni për të lehtësuar punën e komisionit përkatësisht të bëjnë vërejtjet konkrete për një projektligj (vërejtje konkrete për secilin nen veq e veq, nëse ka). Kjo pikë përfundoi me kërkesën e komisionit për një raport me shkrim nga grupi punues për projektligjet që vijnë nga MBPZHR, përkatësisht për këtë projektligj.

Të ndryshme

I. Lulzim Zeneli pasi që u njoftua për shkresën e cila sot ka mbëryt në adresë të këtij komisionit, për shkak të fushveprimtarisë, tha se në fakt kjo shkresë i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit lidhur me shkatërrimet që bëhen në parkun nacional malet e Sharrit. Kjo shkresë është bërë nga Ombudspersoni i Kosovës cili ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës të formoi një komision të veçantë. **Berat Luzha** konfirmoi gjendjen e mjerueshme në këtë park nacional, ngase ky komision në mandatin e dytë ka vizituar këtë park me iniciativën e APK, ndaj sugjeroi komisionin të përgatitet deri të martën për këtë çështje. **Zef Morina** dhe diskutimet në vijim u munduan të sqarojnë se çfarë mund të ndërmerret ky komision në këtë drejtim duke sugjeruar edhe interpelancë nga ministri i MMPH, në fakt çështja kryesore në këtë shkresë konsiston në anulimin e vendimit të MMPH rreth planit Komunal të komunës së Prizrenit. Kjo shkresë në vazhdim ishte shkasë për disa çështje-probleme tjera në rajonin e fabrikës së Niklit e cila vazhdimisht ndotë lumin dhe kontaminon atë (E. Hetemi), mirëpo mendimi i komisionit ishte se ai bënë kontrollin e zbatimit të ligjit e jo kontrollin që bëjnë inspektionet.

Në kuadër të diskutimit rreth çështjes së parashtruar **Berat Luzha** ritheksoi problemin e Obiliqit dhe ndotjes nga KEK-u, por edhe për këtë çështje dominoi mendimi se komisioni nuk mund të bëjë asgjë më tepër por vetëm të alarmoj. **Elheme Hetemi** tha se ndoshta së paku KEK-u kishte mundur të mbuloi këtë pluhur e cila mbulon këtë rajon kur të fryn era. Kryesuesi tha se vetëm Kosova B i tejkalon 500% standardet për emitimin e pluhurit. Komisioni këtë çështje e përmbylli me caktimin e mbledhjes për ditën e martë kur do të ftohen : Ombudspersoni, ministri i MMPH dhe kryetari i Komunës-Prizren.

II. Blerim Vela nga OSCE kërkoi nga komisioni caktimin e vizitave brenda Kosovës të cilat do të shërbejnë për të vazhduar pastaj me caktimin e delegacioneve për dy vizita në rajon : Kroaci dhe Slloveni, pak më vonë edhe në Maqedoni.

III. Berat Luzha insistoi në intensifikimin e punës së këtij komisioni, ngase me këtë tempo si është duke shkuar tani, ai shfaq brengën e joproduktivitetit të punës në këtë komision. Kryesuesi arsyetoi këtë kërkesë duke shtuar se efikasiteti duhet të rritet, për çka është edhe duke u angazhuar ky komision. Kryesuesi propozoi të harmonizohen këto çështje në mbledhjen e radhës me propozime konkrete. **Zef Morina** sugjeroi të mbahen dy mbledhje në javë së paku, çka komisioni parimisht e miratoi ngase shumë gjëra varen nga rrjedhat aktuale.

Mbledhja përfundoi në orën 15,20.

Bajram Badivuku
Admin. i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli